

**DRITAN MURRJA**

**VEPRIMTARIA E ELEZ ISUFIT  
GJATË VITEVE 1921-1924**

**Hyrje**

Veprimtaria e Elez Isufit<sup>1</sup> zuri fill gjatë dekadës së parë të shek. të XX-të, në momente të rëndësishme të historisë së shqiptarëve që lidhen me përpjekjet për të drejta kombëtare, për të vijuar më tej me formimin e shtetit, krijimin e institucioneve dhe demokratizimit të jetës së vendit. Elez Isufi përfaqësonte parinë e krahinës së Trojakut në Dibër ku përfshiheshin Reçi e Dardha. Konaku i tij vendosur në Sllovë në rrugëkalimin që lidhte Dibrën me Lumën dhe më pas Prizrenin e Gjakovën, u bë një strehë e rëndësishme e nacionalistëve shqiptarë.

Në mungesë të shtetit, paria në Dibër konsiderohej një institucion i rëndësishëm që zhvillonte kuvende e merrte vendime, lidhte aleanca, jepte mbështetje politike, por që nuk ishte kompakte. Në radhët e saj pushtuesit kishin mbjellë farën e dasisë dhe përçarjes, se kështu, mund ta kontrollonin më mirë trevën në realizim të interesave të tyre. Por, kjo gjë nuk mund të realizohej në mënyrë të njëanshme, kështu që, pa dyshim edhe elementi lokal vendas pati ndikimin e vet. E. Isufi u rreshtua në krah të parisë, që luftoi dhe mbrojti interesat e krahinës dhe të kombit. Ai nuk u bashkua me Esat Pashën, bashkë me disa krerë të tjerë të Dibrës<sup>2</sup> kur ai

<sup>1</sup> *Elez Isuf Ndreu* (1861-1924), një nga prijësit popullorë të spikatur në Dibër për veprimtarinë e tij patriotike në çështjen kombëtare. Të parët e tij kanë jetuar në Soricë të Dardhës më pas për shkak të vështirësive ekonomike zhvendoset në Lisivalle. Elez Isuf Ndreu karakterizohej nga një sërë cilësish që e bënë atë të autoritetshëm në këtë trevë, njeri i vendosur dhe bashkëpunues, bujar dhe i besës, kokëfortë me atë krenarinë prej malësori, nuk kthente prapa në vendimin e marrë. Megjithëse Elez Isufi ishte i pashkolluar, kjo nuk e pengoi që të kishte një vizion të qartë për shkollën dhe të investonte nga të ardhurat e familjes për hapjen e një shkolle për arsimimin e fëmijëve të familjes së tij të madhe dhe të zonës me mësues Hoxhë Kalla. Xhafer Martini, *Gjenerali me shajak*, Tiranë: Tirana 2000, 2012, f. 12-13.

<sup>2</sup> Haki Stërmilli, *Dibra në prag të Historisë* (dorëshkrim në Arkivin e Institutit të Historisë, Muzeun Historik Dibër), Tiranë: 1940, f. 101. Paria që kundërshtoi të bashkëpunonte me Esat Pashën: Elez Isufi, Sheh Sula i Zerqanit, Ismail

ja kërkoi këtë, sepse i kishte dhënë besën Ismail Qemalit dhe mbështeti qeverinë e Vlorës së bashku me personalitete të tilla si Hasan Prishtina, Isa Boletini, Bajram Curri etj.<sup>3</sup>

Elez Isufi mori pjesë në organizimin dhe udhëheqjen e kryengritjeve antiserbe të viteve 1912-1913, 1915 dhe 1918-1921, deri në çlirimin e plotë të Dibrës nga forcat serbo-jugosllave. Gjatë Luftës së Parë Botërore kur Dibra ishte nën pushtimin e forcave austro-hungareze dhe bullgare Elezi u orientua përkrah atyre forcave përparimtare që shpresuan tek austro-hungarezët që e konsideronin veten si “çlirimtarë”. Si vlerësim i qëndresës kundër serbëve dhe për të forcuar më shumë lidhjet me shqiptarët, Perandori i Austro-Hungarisë, Franc Jozefi, me dekret të 26 janarit 1916, dekoroi E. Isufin me Kryqin e Oficerëve të Urdhrit të Franc Jozefit, si luftëtar i shquar kundër serbëve.<sup>4</sup> Ndaj bullgarëve E. Isufi u distancua për shkak të synimeve aneksioniste të tyre që ishte bërë e njohur tashmë nga Traktati i Shën Stefanit,<sup>5</sup> përfshirë edhe Dibrën.

Në veprimtarinë e tij Elez Isufi u lidh ngushtë me figura të dalluara të nacionalizmit shqiptar si: Ismail Qemal Vlora, Hasan Prishtina, Aqif Pashë Elbasani, Bajram Curri, Isa Boletini. Bashkëpunoi qysh në fillim me “Komitetin për Mbrojtjen Kombëtare të Kosovës” dhe kreun e saj Hoxha Kadri Prishtinën,<sup>6</sup> bëri përpjekje e luftoi bashkë me ta, për realizimin e synimit kryesor të tij: çlirimin e Kosovës të Dibrës dhe bashkimin e tyre me Shqipërinë.

Veprimtaria e Elez Isufit në interes të çështjes kombëtare është e gjerë dhe e shumanshme, por në këtë artikull do të ndalemi tek roli i tij në

---

Strazimiri, Dan Cami, Riza bej Jegeni, Mersim Dema, Dine bej Maqellara, Izet bej Maqellara etj. Pati edhe një numër krerësh si: Selim Dema, Tafë Kaziu, Maliq Bej Jegeni, Xhelal Zogu, Kurt Kodra, Dine Hoxha, Jusuf bej Hysen Agolli, Selim Noka, Dervish Lusha, Suf Xhelili, Ibrahim Tahiri, Ali Bej Zajmi, Kadri Maqellara, e të tjerë e përcollën pashain toptanas deri në Durrës me fuqitë që mblodhën.

<sup>3</sup> Kristaq Prifti, “Kryengritja antiserbe e shtatorit 1913 dhe qeveria e përkohshme e Vlorës, në: *Studime historike*, nr. 1-2, Tiranë: 2004, f. 160.

<sup>4</sup> Bajram Xhafa, *Lufta e Dibrës 1920*, Shkodër: Volaj, 2001, f. 52.

<sup>5</sup> Hilmi Sadikaj, “Qëndresa ndaj pushtimit bullgar në Dibër gjatë Luftës së Parë Botërore (1915-1918)”, në *Dibra dhe etnokultura*, vëll. I, Dibër: Luma, 1995, f. 310.

<sup>6</sup> Marenglen Verli, *Kosova - sfida shqiptare në historinë e një shekulli*, Tiranë: Botimpex, 2007, f. 200.

vitet 1921-1924. Kjo periudhë dhe veprimtaria e Elez Isufit është trajtuar edhe para viteve '90. Autorë të ndryshëm<sup>7</sup> kanë rrokur e trajtuar momente të veçanta të veprimtarisë së tij. Por nën trysinë ideologjike figura është parë tërësisht pozitive duke anashkaluar momente dobësie të tij, i ndikuar nga rrethanat historike, forca kundër vepruese ndaj qeverisë kombëtare që ndoshta në vetvete qëllimmira në aspektin e përgjithshëm të zgjidhjes së çështjes kombëtare, për momentin ishin të dëmshme dhe pengonin konsolidimin e institucioneve të shtetit shqiptar, përpjekje roli i të cilit ishte i domosdoshëm për zgjidhjen e çështjes së dëshiruar prej tyre. Mbështetur në materiale dokumentare e historiografike, studimi synon të trajtojë e analizojë në mënyrë objektive dhe tërësore veprimtarinë e tij në këto vite me dritëhijet që e shoqëruan.

Pas zgjedhjeve të para parlamentare deri në vitin 1924, Elezi u angazhua dhe mori pjesë në lëvizjet politike duke mbështetur krahun irredentist dhe atë liberal-demokrat, duke qenë jashtë mundësive dhe fushës së tij. Suksesi në këtë fushë nuk do të ishte për të si në llogoret e luftës, në shërbim të çlirimit e krijimit të shtetit shqiptar. Elez Isufi kishte fituar një përvojë dhe kishte një intuitë për t'u orientuar drejt, megjithëse ishte i pashkolluar. Por, ashtu si shumë personalitete Oda dhe kuvendet (Shkolla e Dibrës)<sup>8</sup>, i kishin dhënë mundësi të kontaktonte me patriotë të ndryshëm me të cilët kishte dhënë e marrë përvojën e duhur për ta vënë atë në shërbim të luftës për liri.

### **Përpjekjet e qeverisë shqiptare për të shtrirë autoritetin në zonën e Dibrës dhe qëndrimi i Elez Isufit**

Me mbarimin e Luftës së Parë Botërore për dibranët rifilloi një kalvar vuajtjesh, pasi ushtritë serbe iu drejtuan sërish këtyre krahinave, me synim final aneksimin e tyre. Në këtë kohë dibranët të drejtuar nga

<sup>7</sup> Muin Çami, "Lëvizja demokratike e revolucionare shqiptare në vitet 1921-1924", në *Studime historike*, nr. 3-4, Tiranë: 1974; Hysen Kordha, "Lëvizja e Marsit 1922", në *Studime historike*, nr. 3-4, Tiranë: 1976; Xhafer Martini, *Elez Isufi*, Tiranë: Lidhja e Shkrimtarëve, 1994.

<sup>8</sup> Uilliam Tilman, Julian Amery, Peter Kemp, *Kujtime që nuk shlyhen*, Tiranë: Toena, 1997, f. 107. Për qëndrimin e tij në Dibër në vitet '40 të shek. XX oficeri i zbulimit anglez Julian Amery shkruan: "Katër ditë në Dibër më kishin mësuar më shumë për thelbin e politikës, se sa të gjithë librat për teorinë kushtetuese dhe ekonominë politike që i kisha lexuar në Oxford".

Elez Isufi dhe Hazis Kotarja organizuan një kryengritje dhe kundërshtuan me armë vendosjen e pushtimit serb.<sup>9</sup> Situata në Dibër u bë më shqetësuese, në fillim të nëntorit të vitit 1918, kohë kur trupat serbe megjithëse u larguan nga Shkodra, mbanin të pushtuar një pjesë të konsiderueshme të territorit shqiptar që përfshinte krahinat lindore e verilindore si ato të Dibrës së Poshtme (Peshkopisë) në pika të avancuara deri në Qafën e Buallit e Qafën e Murrës, Hasin, Lumën, Malësinë e Gjakovës, Krasniqen e Kelmendin.<sup>10</sup> Kjo zonë përputhej me atë që Beogradi në Konferencën e Londrës së 1913-ës e kishte pagëzuar si “vijë strategjike” ose “kufiri strategjik”, që përfshinte krahas të tjerave edhe gjithë krahinën e Dibrës.

Shqetësimi në parinë e Dibrës për planet e Beogradit erdhi në rritje, veçanërisht kur qeveria jugosllave vendosi, që forcat e saj ushtarake në territorin e “vijës strategjike” në Shqipëri të viheshin në varësi të Ministrisë së Punëve të Brendshme në vend të Ministrisë së Luftës<sup>11</sup>. Ky ndryshim i beftë i qeverisë jugosllave e trajtonte zonën verilindore si një çështje të brendshme, duke synuar ligjërimin e aneksimit dhe vënien para faktit të kryer të Konferencës së Paqes, mbledhur në Paris fill pas përfundimit të Luftës së Parë Botërore. Këto lëvizje të qeverisë jugosllave hasën në kundërshtimin e popullsisë së Dibrës, jo vetëm me armë por edhe me protesta e peticione dërguar qeverisë shqiptare dhe Lidhjes së Kombeve. Pjesë e reagimit ishte edhe Elez Isufi, i cili së bashku me Dine bej Maqellarën dhe anëtarë të tjerë të parisë së Dibrës, më 17 mars 1919, në protestën dërguar qeverisë së Durrësit shprehnin vendosmërinë për mbrojtjen e tërësisë tokësore të vendit kundër pretendimeve të fqinjëve jugosllavë.. “Sot jemi tue marrë vesh se mbretëritë që kemi në kufij, janë tu kërkue toka shqiptare në të cilat sot e afër gjashtë mijë vjet kanë jetuar të parët tanë e ne... t’i dëftohet

<sup>9</sup> Halim Purellku, “Rrethanat politiko-shoqërore në Dibër dhe rrethinë 1918-1920”, në *Dibra dhe etnokultura e saj* vëll. I, Dibër: Luma, 1995, f. 332.

<sup>10</sup> Muin Çami, *Lufta çlirimtare antiimperialiste e popullit shqiptar në vitet 1918-1920*, botim i Universitetit të Tiranës, Instituti i Historisë dhe i Gjuhësisë, Tiranë: 1969, f. 24; Paskal Milo, “Dështimi i përpjekjeve për pushtimin e viseve verilindore të Shqipërisë nga forcat jugosllave 1918-1921”, në *Studime historike*, nr. 1-2, Tiranë: 1988, f. 101.

<sup>11</sup> P. Milo, “Dështimi i përpjekjeve...”, f. 105.

Konferencës së Paqes se shqiptarët e Shqipërisë së robnume sot janë tue luftue me këto tri mbretëri për të qëndru më vedi...”<sup>12</sup>

Kongresi i Lushnjës i janarit 1920, rriti shpresën për çlirimin e zonave që ende ishin të pushtuara. Në kuadrin e detyrave të rëndësishme që kishin të bënin me funksionimin e shtetit, qeveria e Sulejman Delvinës i kushtoi vëmendje edhe zonave të mbetura nën pushtimin serb e atë Italian. Me të drejtën që i jepnin vendimet e Konferencës së Londrës të vitit 1913, qeveria shqiptare mori vendimin për shtrirjen e pushtetit administrative në prefekturën e Drinit, e cila përfshinte zonat verilindore në hapësirën brenda kufirit të 1913, të cilësuar nga serbët si “kufi strategjik”<sup>13</sup>.

Ky vendim gjeti mbështetjen e Elez Isufit, i cili përkrahu udhëzimet e Tiranës zyrtare, dhënë Ramiz bej Dibrës, i porsaemëruar për të kryesuar prefekturën e Drinit. Sipas këtyre udhëzimeve, administrata do të vendosej përkohësisht në Qafë-Murrë, pikërisht aty ku përfundonte “kufiri strategjik”. Me këtë qeveria shqiptare synonte që të shmangte incidentet dhe konflikte me palën serbe, pasi precipitimi i situatës nuk shkonte në favor të Dibrës dhe shtetit shqiptar, ende i dobët si në planin e brendshëm dhe në atë ndërkombëtar. Ahmet Zogu në rolin e ministrit të Brendshëm porosiste: “në emër të atdheut, që të mos i jepni shkas lindjes së ngatërresave me serbët... . Prandaj edhe njëherë ju porosis që të veproni në përputhje me këtë politikë, sepse një gabim i vogël mund të sjellë pasoja shumë të rënda, ta themi më shqip, mund të rrezikojë ekzistencën e atdheut... Qeveria ka marrë parasysh çdo gjë për t'i shpëtuar ata vëllezër që janë duke rënkuar nën kthetrat e armikut. Por ky qëllim do të realizohet kur të vijë koha...”<sup>14</sup> Qëndrimi i Zogut si

<sup>12</sup> *Dibra dhe etnokultura e saj*, vëll. II, Dibër: Luma, 1995, f. 197.

<sup>13</sup> *Lufta e popullit shqiptar për çlirim kombëtar (1918-1920)* (Përmbledhje dokumentesh), vëll. II, botim i Akademisë së Shkencave, Tiranë: 1976, f. 393, dok. nr. 339, Vendim nr. 424, më 4 korrik 1920, i qeverisë së Tiranës për krijimin e prefekturës së Drinit. Në vendim jepej mënyra e organizimit. “Do formohet prefektura me qendër në Peshkopi, në të cilën do të përfshihen nënprefekturat e Lumës, Hasit, dhe Homeshit dhe do të ketë emrin prefektura e Drinit. Në krye të saj emnohet si prefekt majori Ramiz bej Dibra, me rrogën që i përket. Si fuqi për qetësinë e brendshme dhe për me sigurue kufijtë do të shkruhen 500 xhindarmë. T'i jepen si shpenzime të papandehuna një shumë 3000 L italiane në muaj.

<sup>14</sup> *Po aty*, f. 394-395, dok. nr. 340; Bajram Xhafa, *Lufta e Dibrës 1920*, Shkodër: Volaj, 2001, f. 125.

përfaqësues i qeverisë, kishte si qëllim për të mos rënë në grackën e pushtuesve, të cilët e mbanin zonën strategjike me pretendimin e rrezikut të sulmeve nga shqiptarët, me shpresën e zgjidhjes përfundimtare të çështjes së kufirit shqiptaro-serb në Konferencën e Paqes së Parisit.

Por një pjesë e nëpunësve të administratës, prefekti Ramiz Dibra, Jashar Erebara, Ramiz Daci, nën ndikimin e irredentistëve kosovarë veçanërisht të Hasan Prishtinës, nuk i mbështetën udhëzimet e qeverisë dhe në kundërshtim me to nuk u ndalën në Qafë-Murrë, por marshuan dhe u vendosën në Arras (brenda vijës strategjike). Ramiz bej Dibra dhe Ramiz Daci ishin njoftuar nga Hasan Prishtina rreth një mbledhje në të cilën ishte vendosur që dibranët të sulmonin forcat serbe që ndodheshin në Dibër, më 15 gusht 1920<sup>15</sup>. Ky veprim me të drejtë shqetësoi Elez Isufin. Në radhë të parë ishte thyer urdhri i qeverisë për të qëndruar në Qafë-Murrë dhe së dyti, me këtë lëvizje provokoheshin forcat serbe dhe krahina mund të përfshihej nga një sulm i ri me pasoja të dëmshme për popullsinë civile. Isufi kishte shkëmbyer korrespondencë me ministrin Zogu, me të cilin kishte rënë dakord për vendosjen përkohësisht të administratës në Qafë-Murrë. Studiuesi Arben Puto thekson se, - Zogu nuk mund të mbështetej te krerët kosovarë sepse nuk pajtohej me irredentizmin kosovar.<sup>16</sup> Në fakt një qëndrim të tillë kundër një politike irredentiste aktive nuk kishte shfaqë vetëm Zogu, por një pjesë e konsiderueshme e politikanëve të kohës. Një politikë mbështetëse hapur ndaj irredentizmit shihej nga Tirana zyrtare jo vetëm si një mision i pamundur, por edhe e rrezikshme. Fillimisht Elezi mbështeti qëndrimin zyrtar të qeverisë dhe të ministrit të Brendshëm Zogu për të shmangur konfliktin me serbët, por më pas ndryshoi qëndrim.

Me mbërritjen e administratës në Arraz u njoftua Elez Isufi, i cili shkoi, megjithëse në fillim e kishte kundërshtuar. Ky qëndrim i dyzuar i E. Isufit shpjegohet për shkak se u gjend para faktit të kryer dhe refuzimi nga ana e tij mund të pësjtjellohej tek popullsia dhe mbështetësit e tij se

<sup>15</sup> Ismail Strazimiri, *Lufta kundër pavarësimin të Shqipërisë*, Tiranë: Naimi, 2010, f. 102. Letër e Hasan Prishtinës dërguar Ramiz bej Dibrës dhe Ramiz Dacit ku informonte se kishte marrë pjesë në një kongres të fshehtë të zhvilluar mes delegatëve e diplomatëve të kombeve: italianë, hungarezë dhe bullgarë, të cilët kishin përgatitur programin e një kryengritjeje të përgjithshme në Serbi, ku ishte vendosur që dibranët të sulmonin forcat serbe që ndodheshin në Dibër më 15 gusht 1920.

<sup>16</sup> Arben Puto, *Shqipëria politike (1912-1939)*, Tiranë: Toena, 2009, f. 337.

ishte kundër kryengritjes dhe çlirimit të Dibrës. Lidhja që kishte me banorët e kësaj krahine dhe krenaria prej malësori ndikuan që E. Isufi të ndryshonte qëndrim, dhe ai pa humbur kohë pas marrjes së lajmit u gjend në mes të krerëve dhe administratës së prefekturës së Drinit, vendosur në Arras. Gjatë bisedës së zhvilluar me krerët e administratës, çështja e vendosjes së saj në Arras kaloi në plan të dytë, sepse nëpunësit e prefekturës me prefektin Ramiz bej Dibrën dhe parinë kishin tashmë parësore në diskutimet e tyre çështjen e organizimit të kryengritjes për çlirimin e Dibrës. E. Isufi u bë pjesë e kësaj nisme për organizimin e kryengritjes, ku dhe qeveria nuk bëri ndonjë përpjekje për ta penguar, në një farë mënyre e mbështeti ashtu si në rastin e Vlorës. Duket se veprimi i tyre shkonte në të njëjtën linjë me organizimet për çlirimin e Vlorës nga ushtritë italiane. I ndodhur para faktit të kryer, E. Isufi iu bashkua qëndrimit të administratës, përfaqësuesit e së cilës e zgjodhën atë komandant për të drejtuar kryengritjen kundër forcave pushtuese. Lëvizja për çlirimin e Dibrës vazhdoi përgjatë vitit 1920 dhe deri në fund të 1921.

### **Zgjedhjet parlamentare në prefekturën e Drinit dhe Elez Isufi**

Në pranverë të vitit 1921 në prefekturën e Drinit, ndodhën edhe zhvillime të tjera, ku veçohet mbajtja e zgjedhjeve parlamentare. Nëpërmjet zhvillimit të tyre në këtë prefekturë qeveria shqiptare shtrinte pushtetin e saj politik në një zonë që mbahej ende e pushtuar dhe njëkohësisht i përcillte Serbisë mesazhin se prefektura e Drinit ishte pjesë integrale e shtetit shqiptar.

Në zgjedhje konkurronin dy grupime politike, grupimi Popullor dhe grupimi Përparimtar. Në disa krahina të thella e të prapambetura, një rol të rëndësishëm në mbështetje të njërit apo tjetrit grupim dhe të fitores së tyre, luante influenca personale e krerëve, e parisë dhe e bajraktarëve. Duhet theksuar që prefektura e Drinit dhe nënprefektura e Matit kishin dy figura me peshë, që ndikonin në procesin zgjedhor të këtyre dy krahinave. Ahmet Zogu dominonte me influencën e tij në Mat dhe më pak në Dibër. Elez Isufi ishte një nga njerëzit më me peshë në Dibër të Poshtme, dhe më pak në Mat. Për këtë arsye grupimet politike u përpoqën ta përfshijnë këtë të fundit në anën e tyre për të patur sukses në zgjedhjet parlamentare. Por, pozicionimi i E. Isufit ishte i qartë, duke patur parasysh lidhjet e forta të tij me rrethet politike dhe kryesisht me grupin irredentist të

Kosovës, të cilët ishin pjesë e grupimit Përparimtar. Ndërsa A. Zogu ishte pjesë e grupimit Popullor në këto zgjedhje. Ky i fundit, megjithëse i fuqishëm politikisht e dinte mirë lidhjen e të parit dhe autoritetin që gëzonte ai ndër malësorë. Për këtë arsye bëri përpjekje për ta bërë pjesë të grupit të tij. Midis A. Zogut dhe E. Isufit u organizua edhe një takim në Tiranë, por pa arritur ndonjë marrëveshje për bashkëpunim midis tyre.<sup>17</sup> Në këtë periudhë ka të dhëna se marrëdhëniet mes Elez Isufit dhe Ahmet Zogut kanë qenë jo shumë miqësore dhe bashkëpunuese, diçka kishte ndodhur në mes tyre. Ismail Strazimiri, bashkëkohës i Isufit dhe njeri me influencë në Dibër në kujtimet e tij shprehet: “Qofshin të mallkuar ata...që mbollën farën e dasisë e t’urrejtjes në mes personit të vlefshëm të Ahmet Zogut dhe njeriut të plotfuqishëm e ndërgjegjshëm Elez Isufit”<sup>18</sup>. Ndonëse Strazimiri nuk përmend emra, priremi të mendojmë se tek Isufi kishin influencuar irredentistët kosovarë, të cilët nuk e simpatizonin Zogun, pasi ky i fundit ishte bërë pengesë në një sërë nismash me karakter radikal të ndërmarra nga ana e tyre, të cilat po të viheshin në zbatim vinin në rrezik ekzistencën e shtetit shqiptar. Ndikimi i tyre bëri që E. Isufi të mos bashkëpunonte me Zogun gjatë zgjedhjeve parlamentare.

Kandidatët, Iljaz Bej Vrioni, Selaudin Shkoza, Kristo Floqi, Kristo Dako, Irfan Bej (Ohri-D.M.), Gani Bej (Strazimiri-D.M.), Avni Gjilani, Ramiz Daci, Hoxha Kadria, Hasan Prishtina të grupimit Përparimtar në prefekturën e Drinit patën mbështetjen e Elez Isufit, ndonëse disa prej të cilëve ishin pjesë e qeverisë.<sup>19</sup> Mbështetja që Elez Isufi i dha deputetëve të Drinit vinte për arsye se, me një pjesë si me Hoxha Kadrinë dhe Hasan Prishtinën kishte njohje dhe lidhje të hershme, kjo vërehet nga korrespondenca e shkëmbyer me ta. Ndërsa Kristo Dako dhe Kristo Floqi ishin të rekomanduarit e Aqif Pashës të cilin E. Isufi e kishte mik.

Zgjedhjet në prefekturën e Drinit kishin një specifikë. Zgjedhës të dytë do të dilnin jo vetëm nga krahinat e Dibrës të paokupuara por edhe

<sup>17</sup> Gazeta *Ushtima e maleve*, 25 qershor 1980; Xh. Martini, *Elez Isufi...*, f. 90.

<sup>18</sup> I. Strazimiri, *Lufta kundër pavarësisimit...*, f. 119.

<sup>19</sup> *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSH*), Fondi (më tej: F.) 146, Viti (më tej: V.) 1921, Dosja (më tej: D.) 2, fl. 187, dok. nr. 3. Procesverbal i zgjedhjeve të deputetëve të Prefekturës së Drinit, Tiranë, 10 prill 1921. Komisioni i zgjedhjeve të dyta: Ibrahim Xhindi (Kryetar), Aleksandër Xhuvani, Selim Juniku, Haxhi Jusuf Banka (anëtarë), Ismail Efendi (Kryetar i Katundarisë, Tiranë).

nga dibranët muhaxhirë të vendosur në Tiranë, gjë që u jepte mundësi të dy palëve të ndërhyjnë në procesin zgjedhor. Të dy palët abuzuan me numrin e zgjedhësve të dytë që nxorën dhe akuzuan njëra-tjetrën për prishje të procesit. Mbështetësit e Elez Isufit kishin nxjerrë vetëm 27 zgjedhës të dytë, ndërsa ata të grupimit popullor nxorën 89.<sup>20</sup> Numri i ekzagjeruar i zgjedhësve të dytë që paraqitën popullorët u bë shkak për përplasje midis palëve. A. Zogu bëri përpjekje për ta mbrojtur shifrën e zgjedhësve të dytë pranë qeverisë. Në këtë përpjekje Zogu u përkrah nga ministri i Brendshëm Mehdi Frashëri, i cili u mundua të përkrahte rritjen e numrit të zgjedhësve të dytë që e simpatizonin atë.<sup>21</sup>

Elez Isufi protestoi energjikisht kundrejt këtyre metodave. Në krye të një komisioni elektoral, ai shkoi për të biseduar me Mehdi Frashërin. Me ndërhyrjet dhe kërcënimet për dorëheqje të Iljaz Vrionit, ministri Frashëri u detyrua të pranojë që numrin e zgjedhësve të dytë ta ulte nga 89 në 27.<sup>22</sup> Kështu 27 zgjedhësve të dytë që vinin nga Dibra ju shtuan edhe 22 zgjedhës të dytë të dalë prej muhaxhirëve që ndodheshin në prefekturën e Durrësit dhe të Elbasanit. Në total numri i zgjedhësve arriti në 49, të cilët, ishin mbështetës të qeverisë. Këta do të votonin për zgjedhjen e deputetëve. Gjithë sa më sipër tregon se të gjithë deputetët që fituan bënin pjesë në kampin përparimtar çka tregonte se 49 zgjedhësit e dytë ishin sajuar nga autoritetet qeveritare për fitore të plotë të kandidatëve të saj.

Çështja e zgjedhjeve të Drinit nuk do të kalonte në heshtje, por do të bëhej objekt debatesh mes përfaqësuesve të kaheve politike edhe në seancat e para të parlamentit, për arsye se grupi i deputetëve (të grupimit Përparimtar) të zgjedhur në prefekturën e Drinit vendoste për fatin e qeverisjes. Kritikën ndaj zgjedhjeve të Drinit e trajtoi në diskutimin e tij Fan Noli, atëherë, përfaqësues i grupimit Popullor. Ai vuri në dukje parregullsitë e zgjedhjeve aty dhe i konsideroi ato si të dyshimta, për një sërë arsyes: “Qeveria u dha urdhër të zgjidhen këndeje zallit (pjesa ku kishin emigruar), 22 zgjedhës të dytë dhe nga tjetra 27. Këta 49 zgjedhës

<sup>20</sup> *Po aty*, F. 146, V. 1921, D. 2, dok. nr. 14. Memorandum dërguar Kryetarit të Parlamentit nga një përfaqësi e 89 zgjedhësve të dytë, Peshkopi, dt. 21.04.1921.

<sup>21</sup> Burhan Çiraku, “Zgjedhjet e para parlamentare në Shqipëri në vitin 1921”, në *Mbi lëvizjen kombëtare dhe demokratike shqiptare në vitet 1918-1924*, botim i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Instituti i Historisë dhe Gjuhësisë, Tiranë: 1966, f. 158.

<sup>22</sup> *Po aty*.

të dytë u mblodhën dhe votuan më 5 prill 1921 para se t'i jepej kohë anës tjetër të zgjidhte 27 në vend të 89 zgjedhësve të dytë. Ata që ishin nën Serbi u ndaluen të votojnë dhe presin të drejtën prej parlamentit...<sup>23</sup>. Në përfundim të fjalës së tij, Noli kërkoi që deputetët e Drinit të mos pranoheshin në Parlament, madje për atë prefekturë zgjedhjet të përsëriteshin. Kritika e Nolit vinte edhe për shkak se gati gjysma e deputetëve kishin funksione qeveritare. Ai shtronte pyetjen: “Kemi ardhur këtu të mbrojmë të drejtat e popullit apo jeniçerllëkun e ministrave tanë?”<sup>24</sup>

Pas debatesh të gjata dhe të tensionuara çështja e deputetëve të Drinit u vendos që të hidhej në votë, nëse mandati i tyre ishte i rregullt ose jo. Me gjithë kritikën që mori çështja e pjesëmarrjes në votim e deputetëve të Drinit, në kundërshtim me rregullat e parlamentit ata morën pjesë dhe votuan për veten e tyre. Noli përsëri reagon duke u shprehur se: “me qenë se zgjedhja e Drinit asht e dyshimtë si mund të votojnë ata t’ue qenë edhe të gjykuem edhe gjykatës”.<sup>25</sup> Pas votimit deputetët e Drinit fituan me shumicë votash dhe zgjedhjet u konsideruan si të rregullta.

Zgjedhjet e Drinit do të krijonin një precedent në ecurinë e zgjedhjeve dhe të jetës parlamentare në Shqipëri. Klasa politike pa dallim kishte përgjegjësinë për parregullsitë në zhvillimin e tyre, por grupimi në pushtet kishte pjesën më të madhe të saj. Nga 10 deputetë që nxori prefektura e Drinit asnjë nuk u zgjodh nga grupi i Popullorëve, vetëm ky fakt flet shumë. Zgjedhjet e deformuara, u bënë shkak për përshtjellimin e situatës politike në të ardhmen, e cila u shoqërua me, krizën politike të dhjetorit 1921. Edhe ndryshimet e shpeshta të kabineteve qeveritare në vijim, e kanë zanafillën pikërisht këtu. Acarimi i luftës politike e sociale gjatë fushatës së zgjedhjeve të para parlamentare dhe vazhdimi i saj në gji të parlamentit çoi në një polarizim të mëtejshëm të forcave shoqërore.<sup>26</sup>

Çështja e zgjedhjeve të Drinit do të rihapej për debat sërish, në dhjetor të vitit 1921 pas çlirimit të Dibrës, nga trupat jugosllave. Paria konservatore e Dibrës që mbështeti Zogun gjatë zgjedhjeve, i drejtonte

<sup>23</sup> *Bisedimet e Këshillit Kombëtar* (më tej: *BKK*), V. 1921, f. 18-19. Nga fjala e Nolit në parlament.

<sup>24</sup> *Gazeta Koha*, 4 qershor 1921.

<sup>25</sup> *BKK*, V. 1921, f. 1-2; *Gazeta Shkumbini*, 13 maj 1921; *Gazeta Koha*, Korçë, 4 qershor 1921, f. 2.

<sup>26</sup> Hysen Kordha, “Ngjarjet e dhjetorit 1921”, në *Studime historike*, nr. 1-2, Tiranë: 1974, f. 41.

një letër kryesisë së Parlamentit ku i kërkonte të zhvilloheshin sërish zgjedhje në prefekturën e Drinit pasi Dibra ishte çliruar. “Lutemi të jepet urdhër për zhvillimin e zgjedhjeve që të përfaqësohemi nga deputetët tanë të zgjedhun prej shpirtit të popullit”.<sup>27</sup> Pretendimi i tyre mbështetej tek klauzola e ligjit për zgjedhjet e Drinit që kishte përcaktuar se: “Mbasi të lirohet prefektura e Drinit nga Serbia deputetët e kësaj prefekturë janë të detyruar me i njoftue vendimin popullit që nuk pat marrë pjesë në zgjedhje...”.<sup>28</sup> Kërkesa drejtuar parlamentit erdhi pikërisht në një moment ku situata politike ishte në favor të Zogut. Ngjarjet u zhvilluan me shpejtësi, dhe i dhanë mundësi Ahmet Zogut të kontrollonte parlamentin. Ai kthehet në Tiranë pas suksesit në operacionin e Mirditës, i cili shtypi të ashtuquajturën “Republikë e Mirditës”. Në këtë kohë kishte dhënë dorëheqjen dhe qeveria e Hasan Prishtinës.

Në seancën e parë të parlamentit të datës 22 dhjetor 1921 u shqyrtua çështja e zgjedhjeve në prefekturën e Drinit, pas lirimit të saj prej forcave serbe. Koço Tasi shprehet se: “deputetët e Drinit kanë të drejtë të qëndrojnë në parlament deri sa të bëhen zgjedhjet e reja”.<sup>29</sup> Në seancë u lexua edhe një shkresë e krahinës së Dibrës e firmosur prej 122 vetësh me të cilën kërkonin: “zgjedhje të reja në atë prefekturë, pasi nuk kishin marrë pjesë në zgjedhjet e fundit”.<sup>30</sup> Punimet e seancës u zhvilluan në kushte tensioni ndërmjet kaheve politike, pasi jashtë dyerve të parlamentit qëndronin forcat që mbështetnin Zogun, si dhe forca dibrane të Elez Isufit dhe forca të Martaneshit mbështetës të Aqif Pashës. Parlamentarët të ndikuar edhe nga ky presion ku ndjehet dukshëm fuqia e Zogut, votoi me 40 vota pro rrëzimit, dhe 5 vota kundër rrëzimit të

<sup>27</sup> *AQSH*, F. 146, V. 1921, D. 2, fl. 304, dok. nr. 744/II. Letër e parisë së Dibrës dërguar Kryesisë së Parlamentit, Peshkopi, 12 dhjetor 1921. Disa nga firmëtarët e kërkesës nga paria: Dine bej Maqellara (Maqellarë), Selim Noka (Çidhën), Shehat Sheh Ymeri (Peshkopi), Arif Kaloshi (Kandër), Abas Bej Xhilaga (Deshat), Zenel Bej Hasanaj (Dohoshisht), Osman ef. Shehu (Zerqan), Baba Elmaz (Bulgizë).

<sup>28</sup> *Po aty*, F. 822, V. 1921, D. 35, fl. 11, dok. nr. 708.785. Interpretim i artikullit VII për zgjedhjet e Drinit, dt. 3 janar 1921. Sipas artikullit VII të ligjit për zgjedhjet e Drinit thuhet: “Mbasi të lirohet prefektura e Drinit nga Serbia deputetët e kësaj prefekturë janë të detyruar me i njoftue vendim popullit që nuk pat marrë pjesë në zgjedhje, edhe në qoftë se vërtetohen të zgjedhurit e këtyre quhet i mbaruar, për kundrazi kanë për t’u bërë zgjedhje të reja”.

<sup>29</sup> *BKK*, 22 dhjetor 1921, mbledhja e 72, f. 586. Diskutime në seancë mbi shkarkimin e deputetëve të Drinit.

<sup>30</sup> *BKK*, V. 1921, f. 591.

deputetëve të prefekturës së Drinit.<sup>31</sup> Ky vendim i parlamentit nuk shqetësoi vetëm deputetët e prekur drejtpërdrejtë, por edhe Elez Isufin, i cili jo pak kishte kontribuar për zgjedhjen e tyre.

Në kundërshtim me ligjin zgjedhor dhe kërkesën e dibranëve në parlament për zhvillimin e zgjedhjeve të reja në Dibër, para votimit disa deputetë të Drinit si Hasan Prishtina, Hoxha Kadria, Ramiz Daci etj., i nisën një letër Elez Isufit ku e informonin për situatën që po ndodhte në Tiranë duke nënvizuar synimet diktatoriale të Ahmet Zogut: “Parlamenti t’ue kujtue se Ahmeti e ka fuqinë në dorë e t’ue pasë frikë që të mos qesë ngatërresa, duket se ka me ja dëgjue të tana dëshirat. Prandaj e shohim të nevojshme...me sa fuqie që të mundesh të nisesh për Tiranë, për me ja mbushë mendjen parlamentit (parlamentarëve-D.M.) se fuqinë nuk e ka Ahmet Zogu”.<sup>32</sup>

I paqartë rreth këtyre opsioneve të forcave politike, pastërvitur në luftën politike, ndonëse me intuitë të madhe, Elez Isufi preferoi të ishte i matur dhe i kujdesshëm përpara se të hidhte hapa për organizimin e një lëvizjeje për zgjidhjen politike që i kërkohej. Megjithatë ai nuk heshti, por i drejtoi një telegram parlamentit, i cili u lexua në mbledhjen e 75-të të tij më 24 dhjetor. Midis të tjerash, ai theksonte se: “...n’emën të dibranëve...i sjell ndërmend parlamentit detyrën që i ka ngarkuar populli dhe i rekomandon drejtësi e urtësi..., përndryshe asht gati me i tregue gjithkujt që e ka mendjen për të zënë poste në qeveri, vendin e vet”.<sup>33</sup> Ky mesazh i drejtohej në mënyrë të veçantë Ahmet Zogut dhe pasuesve të tij, që të respektonin institucionet që kishin dalë nga Kongresi i Lushnjës. Zogu, nga ana e tij, nuk e neglizhoi kërcënimin e Elez Isufit, por e mori shumë seriozisht. Nga prefektura e Drinit kërkonte informacione të

<sup>31</sup> *AQSH*, F. 149, V. 1921, D. 1884, fl.5-6 (dy kopje). Shkresë e Kryetarit të Këshillit Kombëtar, z. Eshref Frashëri dërguar Kryeministrit, Xhaferr Ypi, Tiranë, 22 dhjetor 1921. “Mbi rrëzimin e deputetëve të Drinit”, në gazetën *Shqipëri e Re*, 29 janar 1922; *Gazeta Mbrojtja Kombëtare*, 29 dhjetor 1921, f. 2. Vendim i parlamentit për votim me 40 vota pro rrëzimit, dhe 5 vota kundër rrëzimit të deputetëve të prefekturës së Drinit Hoxha Kadriu, Hasan Prishtina, Ramiz Daci, Irfan Ohri, Kristo Dako, Kristo Floqi, Gani Strazimiri, Selaydin Shkoza, Avni Gjilani, Iljaz Vrioni, me qenë se u liruan viset e asaj prefekturë.

<sup>32</sup> *AQSH*, F. 441, V. 1921, D. 56, fl. 1. dok. nr. 27/1. Letër e disa deputetëve të Drinit (H. Prishtina, H. Kadria, R. Daci, K. Dako) dërguar Elez Isufit, Tiranë, 21 dhjetor 1921.

<sup>33</sup> *Muzeu Historik i Dibrës* (më tej: *MHD*), dosja Elez Isufi, nr. 138, viti 1987 (dokumente e kumtesa), f. 4.

vazhdueshme, pasi nga të dhënat e ndiente se diçka po lëvizte në atë trevë. Situata e krijuar më pas i çoi palët drejt një konflikti të armatosur, tek Lëvizja e Marsit.

### **Elez Isufi në mbështetje të Lëvizjes së Marsit të vitit 1922**

Lëvizja e Marsit e vitit 1922 me vatrën e saj në Tiranë, Durrës, Dibër ku Elez Isufi ishte një ndër protagonistët e saj më kryesorë vuri në rrezik qeverinë e Xhafer Ypit. Shtypi i kohës është shprehur për synimin politik të lëvizjes. Ata, theksonte gazeta “Ora e Maleve”: “pasi shtinë në dorë pushtetin në dhjetor 1921, s’donin me ndigjue zanin e popullit, s’donin Asamblenë Kushtetuese”.<sup>34</sup> Konservatorët kundërshtuan mbledhjen e Asamblesë Kushtetuese, e cila do të zgjidhte çështjen e regjimit e të kryetarit të shtetit. Si moto të lëvizjes kryengritësit bënë domosdoshmërinë e mbledhjes së Asamblesë Kushtetuese, e cila shihej nga juristët e grupimit Përparimtar, jo vetëm tek vlerat juridiko-kushtetuese e rolin konstitucional në veprimtarinë e organeve shtetërore, por edhe si plotësim të bazave të organizimit shtetëror të përcaktuar në Kongresin e Lushnjës. Me këtë ata synonin rrëzimin e konservatorëve nga pushteti.

Veç synimit politik lëvizja kishte edhe qëllime ekonomike e sociale. Me këtë, kërkonin të frenonin politikën ekonomike të konservatorëve, të cilët pas ardhjes në pushtet, vendosën taksat e reja, që kishin rënduar më tej gjendjen ekonomike të popullit. Këtë e pohon edhe Elez Isufi, i cili duke shpjeguar shkaqet që nxitën popullin e Dibrës të ngrihej në Lëvizjen e Marsit theksoi: “...populli i Dibrës është helmuar nga kjo qeveri sepse ka vënë taksat të rënda dhe si lë të qetë”.<sup>35</sup> Taksat dhe mbledhja e të prapambeturave sipas vendimit të qeverisë<sup>36</sup>, e kishin përkeqësuar gjendjen e popullsisë. Pakënaqësia karshi qeverisë u shtua edhe nga mënyra sesi u bë procesi i çaromatimit. Ndonëse ndërmarrja e këtij procesi ishte një veprim i duhur, që synonte sigurimin e qetësisë dhe vendosjen e autoritetit shtetëror në vend, ai qe selektiv dhe jo

<sup>34</sup> Gazeta *Ora e maleve*, Shkodër, 19 korrik 1921.

<sup>35</sup> Gazeta *Posta e Korçës*, Korçë, 18 mars 1922.

<sup>36</sup> *Qarkore e Ministrisë së Punëve të Brendshme*, V. 1921, 2 tetor, f. 61.

gjithëpërfshirës<sup>37</sup>. Në përfundim u çarmatosën vetëm ato shtresa të popullsisë që paraqisnin rrezik dhe pengesa në rrugën e forcimit të pushtetit të A. Zogut. Vendimi përfshinte, sidomos zonat veriore, ku kishin influencë prijësit kosovarë, të cilët prisnin rastin për të hequr qafe Zogun.<sup>38</sup>

Përballë qeverisjes Ypi-Zogu<sup>39</sup> u vunë të gjithë ato forca politike dhe individë të veçantë, të cilët u prekën politikisht me vendimet e parlamentit të 22 dhjetorit 1921. Përveç deputetëve të Drinit u shkarkuan edhe dy anëtarët e Këshillit të Lartë, Aqif Pashë Elbasani dhe imzot Luigj Bumçi. Pas Bumçit qëndronin edhe forcat e klerit katolik e veçanërisht qarqet e larta të popullsisë katolike. Në këtë grupim u rreshtuan edhe ish deputetët e Drinit: Hoxha Kadriu, Hasan Prishtina, Ramiz Daci etj. Qëndrim opozitar për shkaqe rivalitetesh politike dhe ambiciesh karrieriste mori edhe fraksioni proitalian i përbërë nga Hamit Toptani, Myfit Libohova, Mustafa Kruja etj.<sup>40</sup> Në këtë grup u bashkuan edhe deputetët e Durrësit që ndodheshin nën influencën e Hamit Toptanit si dhe Stavro Vinjau, Luigj Gurakuqi dhe forcat patriotike jashtë parlamentit Bajram Curri, Avni Rustemi<sup>41</sup>. Në krah të tyre qëndroi edhe Elez Isufi etj.

Pas besës së lidhur me Bajram Currin, Elez Isufi me forcat që drejtonte u nis në drejtim të kryeqytetit për rrëzimin e qeverisë<sup>42</sup>. Në kuadër të masave të marra kundër kryengritësve, prefekti i Drinit vinte në dukje se: “Lurja i ka zanë të gjitha grykat për kundër fuqisë së Elez Isufit. Halit Lleshi e Sali Ohri me një pakicë njerëz gjenden në zonën neutrale...”<sup>43</sup>, ndërsa prefekti i Kosovës Bedri Pejani njoftonte MPB se: “krahina e Kalisit ka marrë urdhër me godit forcat e Elez Isufit në qoftë

<sup>37</sup> Valentina Duka, *Histori e Shqipërisë (1912-2000)*, Tiranë: SHBLU, 2007, f. 138.

<sup>38</sup> *Po aty*, f. 138.

<sup>39</sup> *BKK*, V. 1921, 24 dhjetor, f. 642. Përbërja e qeverisë: Xhafer Ypi - Kryeministër, Hysein Vrioni - ministër i Drejtësisë, Fan Noli - ministër i Jashtëm, Ahmet Zogu - ministër i Brendshëm, Kolë Thaçi - ministër i Financave, Spiro Koleka - ministër i P. Publike, Rexhep Mitrovica - ministër i Arsimit, Ismail Tatzati - ministër i Luftës.

<sup>40</sup> H. Kordha, “Lëvizja e Marsit ...”, f. 144.

<sup>41</sup> *Po aty*, f. 131.

<sup>42</sup> *AQSH*, F. 152, V. 1922, D. 9, fl. 18. Telegram i Prefektit të Drinit Sali Vuçiterni, dërguar ministrisë së Punëve të Brendshme, Peshkopi, 27 shkurt 1922.

<sup>43</sup> *Po aty*, fl. 40. Telegram i Prefektit të Drinit z. Sali Vuçiterni dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme, Peshkopi, 10 mars 1922.

se nuk veprojnë si forcat e Bajram Currit”<sup>44</sup>, të cilat u tërhoqën nga lëvizja. Bajram Curri dhe Halit Lleshi me forcat e tyre nuk arritën të futen në Tiranë, pasi i pari u kundërshtua nga paria e Shkodrës, të cilët nuk i lanë asnjë fije shprese për mbështetje. Përkundrazi ata i kthyen përgjigje se: “do të reagonin ashpër”<sup>45</sup>. Ndërsa Halit Lleshi u tërhoq dhe shpërndau forcat e tij për shkak të ndërhyrjes së trupave qeveritare të drejtuara nga Ferit Frashëri dhe Shefqet Korça.<sup>46</sup> Kështu Elez Isufi mbeti i vetëm në veprimin e tij të armatosur. Qeveria bëri të gjitha përpjekjet për t’i ndaluar kryengritësit, përdori çdo mjet presioni e shantazhi ndaj familjeve të atyre që ishin angazhuar me forcat në lëvizje. Më 2 mars 1922 prefektura urdhëroi për djegien e shtëpive dhe konfiskimin e pasurisë, në rast se nuk pendohen për t’u kthyer.<sup>47</sup> Por edhe këto masa nuk patën efekt. Forcat e drejtuara nga Elez Isufi nëpërmjet itinerarit lëvizës: Krej-Lurë, Kthellë, Cudhi të Krujës, Burizanë përfunduan në Fushë-Krujë.<sup>48</sup>

Më 5 mars Elez Isufi me forcat e tij arriti në fshatin Mafsheq të Krujës, ku u takua me Mustafa Krujën dhe Bazin e Canes (Abaz Kupi)<sup>49</sup> për të koordinuar veprimet e mëtejshme të përbashkëta. Me forcat e Elezit u bashkuan edhe fshatarë të zonës, të cilët shtinë në dorë postën zyrtare qeveritare të Fushë-Krujës duke u bërë rrezik i drejtpërdrejtë për Tiranën.<sup>50</sup> Pas triumfit në Valias, forcat kryengritëse lëvizën me shpejtësi dhe duke u gdhirë 9 marsi, u futën në dy lagje në verilindje të kryeqytetit, në atë të Ali Beut dhe të Ismail Efendiut.<sup>51</sup> Ndalimi i luftimeve i dha mundësi Ahmet Zogut që më datë 9 mars 1922 të organizonte një mbledhje në Bashkinë e Tiranës ku morën pjesë disa përfaqësues të

<sup>44</sup> *Po aty*, F. 152, V. 1922, D. 9, fl. 47, Shkresë e Prefektit të Kosovës Bedri Pejani dërguar Ministrisë së Punëve të Brendshme, Krumë, 16 mars 1922.

<sup>45</sup> *Qarkore e Ministrisë së Punëve të Brendshme*, V. 1922, f. 202; Sejfi Vllamasi, *Ballafaqime politike në Shqipëri (1897-1942)*, Tiranë: Neraida, 2000, f. 282.

<sup>46</sup> S. Vllamasi, *Ballafaqime politike ...*, f. 283.

<sup>47</sup> *AQSH*, F. 152, V. 1922, D. 12, fl. 1, Urdhër i Prefektit të Drinit Sali Vuçitani, i cili ishte kundër atyre që kishin shkuar pas Elez Isufit, Peshkopi, 2 mars 1922.

<sup>48</sup> H. Kordha, “Elez Isufi në krye të dibranëve në lëvizjen e Marsit 1922”, f. 4. në: *MHD*, Dosja: Elez Isufi.

<sup>49</sup> *AQSH*, F. 158, V. 1922, D. 23, fl. 1, Njoftim i autoriteteve vendore dërguar Komandës së Përgjithshme Operacionale, Shijak, 15 mars 1922.

<sup>50</sup> *Gazeta Shqipëri e Re*, 2 prill 1922, f.1

<sup>51</sup> *AQSH*, F. 158. V. 1922, D. 23, fl. 2, Informacione të Komandës së Rrethit - Tiranë, Toger Selim Libohova, Tiranë, 15 mars 1922.

parisë së qytetit.<sup>52</sup> Në mbledhje u shqyrtua gjetja e rrugëve për përballimin e gjendjes dhe u caktua një delegacion që do të shkonte të bisedonte me Elez Isufin për ta bindur atë të ndërpresë luftën e nisur kundër qeverisë. Në përzgjedhjen e delegacionit Zogu u tregua i kujdesshëm në gjetjen e njerëzve më me influencë dhe bindës, të cilët mund të bënin diçka në qetësimin e situatës së nderë që po kalonte kryeqyteti. Në krye të delegacionit u vu Vehbi Dibra.

Për shkak të situatës së krijuar, përveç delegacionit, iu kërkua ndihmë edhe përfaqësuesit britanik Harry Eyres, i cili u tregua i gatshëm për të dhënë ndihmesën e tij. Eyres e shihte fitoren e forcave antiqeveritare si forcim të ndikimit të Romës në dëm të Londrës. E vlerësonte kështu, për shkak të orientimit proitalian të një pjese të drejtuesve të kryengritësve, fitorja e të cilëve mund të vinte në pikëpyetje marrëveshjet konçensionare të lidhura midis qeverisë shqiptare dhe Shoqërisë Anglo-Persiane në vitin 1920 për shfrytëzimin e vajgurit,<sup>53</sup> si dhe e shihte me sy kritik lëvizjen, e cila synonte të përmbyste qeverinë me dhunë, që mund të shkaktonte destabilitet në vend dhe rajon. Një përpjekje e tillë e Elez Isufit binte në kundërshtim me vendosjen e një sistemi demokratik, për të cilin pretendonin iniciuesit e saj. H. Eyres bëri të gjitha përpjekjet për të shpëtuar qeverinë Ypi-Zogu nga përmbysja. Në një telegram drejtuar Foreign Office-i Eyres shprehet ndër të tjera për këtë ngjarje: “mendova si të drejtë t’i jepja mbështetjen time qeverisë, tek e cila jam akredituar dhe gjithashtu të parandaloja nëse ishte e mundur gjakderdhjen dhe shkatërrimin e një pjese të madhe të qytetit. Isha tepër me fat që pata sukses, qeveria dhe populli i Tiranës më shprehën mirënjohjen.”<sup>54</sup>

Në takimin me Eyres, Elez Isufi rreth shkaqeve që e shtynë atë, e popullin e Dibrës, të ngrihej kundër qeverisë përmend dy faktorë: i pari politik që lidhej me rrëzimin e deputetëve të Drinit: “...parlamenti,- theksoi ai, që zgjedhur kur serbët mbanin tërë Dibrën të pushtuar...

<sup>52</sup> Qazim Xhelili, *Vehbi Dibra - personalitet dhe veprimtar i shquar i lëvizjes kombëtare*, Tiranë: Albin, 1998, f. 180.

<sup>53</sup> *Historia e Popullit Shqiptar*, vëll. III, botim i Akademisë së Shkencave të Republikës së Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: Toena, 2007, f. 185.

<sup>54</sup> Albana Mema, “Aspekte të veprimtarisë së institucioneve politike në Shqipëri gjatë vitit 1922”, në *Studime historike*, nr. 1-2, Tiranë: 2014, Foreign Office (më tej: FO) 371/7331, f. 427-429, Telegram i Eyres mbi ngjarjet e marsit 1922, Durrës, 16 mars 1922.

parlamenti i kishte përjashtuar deputetët e Drinit me arsyetim se ata nuk ishin zgjedhur rrugës së rregullt. Kjo gjë e la Dibrën pa përfaqësim në Këshillin e krerëve<sup>55</sup>; i dyti ekonomik, pasi me politikën e saj qeveria u kishte krijuar shumë vështirësi banorëve të kësaj treve.

Mustafa Kruja pohon se, E. Isufi kishte ngritur krye për arsye personale pasi njerëzit e tij me urdhër të A. Zogut i kishin bërë shërbime shtetit si forca civile për ruajtjen e kufirit prej shkeljeve të serbëve për disa muaj. Ata kërkonin pagesën e vet, pasi siç theksonte Elezi, “ishin të varfër dhe nuk kishin më durim me prit”. Në marrëveshjen e arritur Kruja përmend, se Zogu pranoi t’i dorëzonte të nesërmen 20 mijë napolona ar nga 30 që kishte kërkuar Elezi.<sup>56</sup> Kjo mund të ishte një arsye më shumë që Elezi mori këtë nismë. Por pa qenë shtysa kryesore. Dihet që ai kishte bërë një marrëveshje me Bajram Currin dhe plani ishte koordinuar edhe me ish deputetë të Kosovës, të shkarkuar. Edhe vetë Mustafa Kruja e Zija Dibra ishin bashkautorë të skenarit, por kur ai dështoi ata e konsideruan si nismë personale të E. Isufit. Ky version nuk mbështetet as nga Ahmet Zogu, i cili gjatë marrëveshjes i thotë Elezit: “Ti je patriot dhe nuk ke aspak faj, duke i kërkuar të veçohesh nga bukëshkalët. – Fajtorë janë Zija Dibra dhe Mustafa Kruja”.<sup>57</sup>

Elez Isufi kërkoi si kusht të marrëveshjes për t’u tërhequr, që mbështetësit e tij të largoheshin nga Tirana të armatosur dhe të mos prekeshin nga forcat qeveritare. Ai do të tërhiqej, mbasi merrte premtimin e faljes për vete dhe për ndjekësit e tij.<sup>58</sup> Në dorëzanimin e Eyres kërkesat e Elezit u plotësuan dhe ky i fundit pranon tërheqjen. Si një njohës i mirë i Ballkanit, dhe me një karrierë të gjatë diplomatike, Eyres mundi të bindë Elez Isufin të tërhiqet nga kjo nismë që kishte marrë, ç’ka solli ndryshim të situatës në favor të Zogut.<sup>59</sup> Gjatë kthimit për në Dibër, Hamit Bej Toptani i dërgoi fjalë Elez Isufit në Krujë që të kthehej për të sulmuar prapë Tiranën, por Elezi nuk pranoi. Ata vazhduan

<sup>55</sup> Rozë Uildër Lein (Roze Wilder Lane), *Majat e Shalës*, Tiranë: Argeta-LMG, 2004, f. 240.

<sup>56</sup> Mustafa Kruja, *Anthologji historike*, Elbasan: Sejko, 2001, f. 300-301; Albana Mema, “Aspekte të veprimtarisë së institucioneve ...”, f. 135.

<sup>57</sup> Nina Smirnova, *Histori e Shqipërisë përgjatë shekullit XX-të*, Tiranë: Ideart, 2004, f.115.

<sup>58</sup> Tajar Zavalani, *Histori e Shqipërisë*, Tiranë: Phoenix, 1998, f. 274.

<sup>59</sup> Bernd J. Fischer, *Mbreti Zog dhe përpjekja për stabilitet në Shqipëri*, Tiranë: Çabej, 2004, f. 18.

rrugën e kthimit pak a shumë në të njëjtin itinerar, kalojnë në Qafë Shtamë, Peshkash, Kthellë, Bresht të Mirditës, në Krej Lurë,<sup>60</sup> dhe më pas u shpërndanë. Elezi u kthye në vendlindjen e tij, në Sllovë. Mbi tërheqjen e Elez Isufit janë dhënë disa mendime.

Është me interes të përpiqemi t'i japim përgjigje një pyetjeje që lind vetiu: Përse Elez Isufi e ndërpreu luftën dhe u kthye në Dibër pa e arritur qëllimin? Ndikimi i Vehbi Dibrës e i delegacionit të dërguar nga qeveria dhe veçanërisht presioni i përfaqësuesit britanik H. Eyres, janë dy faktorë kryesorë. Në këtë përfundim arrin edhe Noli kur pohon: "kryengritësit do ta kishin pushtuar tërë kryeqytetin...sikur të mos hynte në mes ministri anglez H. Eyres".<sup>61</sup> I mbetur vetëm, pa asnjë përkrahje ushtarake, por edhe i zhgënjyer nga motivet e fillimit, ai nuk kishte rrugë tjetër përveç armëpushimit dhe kthimit. Pak i besueshëm ishte mendimi i hedhur në ndonjë studim, i cili i mbështetur në kujtime të Abdulla Çangës, sekretar i Elez Isufit dhe pjesëmarrës në lëvizje që "Këtë marrëveshje Elezi e bëri se ishin mbaruar fishekët... Këtë gjë nuk e dinin as Zogu, as legata angleze. Këto m'i tha vetë Elezi".<sup>62</sup> Ndoshta kjo, mund të ishte justifikim i Elez Isufit për të mos demoralizuar mbështetësit e tij dhe për të ruajtur influencën në Dibër. Arsye tjetër që e shtyu Elez Isufin për të bërë kompromis, ishte se ai nuk u mbështet ashtu siç ishte parashikuar nga forcat e Currit e të H. Lleshit, të cilët e lanë të vetëm përballë forcës qeveritare. Mosardhja e tyre e çmotivoi Elez Isufin, i cili bashkë me pasuesit e tij u ndjeu i tradhtuar.

Këtë ai e shprehu në analizën që u bëri më vonë ngjarjeve. "...Kur e kuptova se u gabova dhe u tradhtova, theksonte ai,- burrnisht hyna në marrëveshje me ndërmjetësin e ministrit anglez dhe dola me nder prej Tirane... mbas sodit nuk do të përzihem ma në punët e popullit. Do të merrem vetëm me punët e mia, sepse zemrat e padjallëzuese të malësorëve si ne, nuk mund të bashkohen me zemrat dredharake të njerëzve të mëdhenj. Tashti e mora vesh që bahen heroizma për interesa e jo therorina për Atdheun".<sup>63</sup> Përveç pendesës ai ndjeu edhe një lloj krenarie prej e malësori, pasi mundi të siguronte amnistinë për pasuesit e tij me anë të marrëveshjes së bërë mes tij dhe Zogut në prani të Eyres.

<sup>60</sup> *Revolucioni i Qershorit 1924 në kujtimet e bashkëkohësve*, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Instituti i Historisë, Tiranë: 8 Nëntori, 1974, f. 63.

<sup>61</sup> *Gazeta Shqiptari i Amerikës*, Korçë, 28 nëntor 1922.

<sup>62</sup> Xh. Martini, *Elez Isufi ...*, f. 97.

<sup>63</sup> I. Strazimiri, *Lufta kundër pavarësisimit...*, f. 138.

Ministria e Punëve të Brendshme urdhëroi prefekturën e Dibrës që të mos bënte operacione në Reç e Dardhë, për shkak të amnistisë.<sup>64</sup> Megjithëse i fali krerët e Dibrës dhe mbështetësit e tyre në Lëvizjen e Marsit, Ahmet Zogu nuk mund të harronte vështirësinë në të cilën u gjend qeverisja e tij nga sulmi i dibranëve.

Pas amnistisë që u dha për krerët e Dibrës dhe pjesëmarrësit e Lëvizjes së Marsit, nuk kaloi shumë kohë dhe qeveria, nisi hakmarrjen. Në anën tjetër, Ahmet Zogu nuk mund t'ia falte kaq lehtë Elez Isufit që, për pak, i kishte rrezikuar pushtetin, dhe kokën. Eliminimi fizik i tij i ishte besuar prefektit të Peshkopisë. Ky i fundit për ta tërhequr nga Slllova, me anë të një shkrese zyrtare tepër sekrete e shkruante se: “Pranë kësaj prefekturë është formuar një komision, i cili do të merret me pajtimin e gjaqeve në gjithë Dibrën. Si i moshuar dhe me përvojë që jeni dhe keni dijeni të shumta për këtë çështje, jeni caktuar si anëtar i këtij komisioni për të na ndihmuar rreth këtij problemi. Nuk duhet të mungoni...”.<sup>65</sup> Por, Elez Isufi nuk pranoi. Nëpërmjet sekretarit të tij, i ktheu përgjigje duke i thënë se mungesa e tij nuk do ta pengonte fare qeverinë dhe komisionin për të vepruar rreth atij problemi për të cilin janë të angazhuar.<sup>66</sup>

Nuk kaloi shumë kohë dhe prefektura e Peshkopisë i dërgoi një shkresë të dytë Elez Isufit, ku i kërkonte të paraqitej me urgjencë për çështjen e pajtimit të gjaqeve. Këtë radhë Elezi përgjigjet prerë: “Në Peshkopi nuk mund të vij. Jemi këtu në Slllovë (vendlindja e tij), urdhëroni me sa fuqi të keni”.<sup>67</sup> Elez Isufi nuk mund të binte në grackë, pasi qeveria i kishte dhënë provat për pabesitë duke shkelur marrëveshjen për amnisti, dhe eliminimin e patriotëve, pjesëmarrës në Lëvizjen e Marsit. Për rrezikun që i kanosej, ai vuri në dijeni legatën angleze. Kjo del nga korrespondenca midis MPB dhe prefekturës së Dibrës në shkurtin e vitit 1923. Në një telegram të MPB drejtuar prefekturës së Dibrës

<sup>64</sup> *AQSH*, F. 152, V. 1922, D. 9. fl. 133. Ministria e Punëve të Brendshme njoftonte prefekturën e Drinit të mos bëhej operacion në Reç e Dardhë për shkak të amnistisë, Tiranë, mars 1922.

<sup>65</sup> Abdulla Çanga, “Elez Isufi në ngjarjet e Revolucionit të Qershorit 1924”, në *Revolucioni i Qershorit 1924...*, f. 179. Abdulla Çanga ka punuar për 8 vjet si mësues në fshatin Slllovë (vendlindja e Elez Isufit). Ka jetuar në shtëpinë e Elez Isufit, të cilit i ka shërbyer edhe si sekretar. Ishte me origjinë nga Shkodra.

<sup>66</sup> Po aty.

<sup>67</sup> Po aty.

theksohej se: “Jeni në dijeni se kundër Elez Isufit po përgatitet një komplot? Keni kujdes dhe hiqni dorë prej këtyre sendeve”.<sup>68</sup> Në përgjigje prefektura njoftonte MPB se: “lajmi...nuk asht aspak i vërtetë por krejt i rremë”.<sup>69</sup> Njoftimin e prefekturës së Dibrës, MPB ia përcolli përfaqësuesit anglez H. Eyres. Pas kësaj, Elez Isufi u la i qetë, deri në ngjarjet e dhjetorit 1924.

Pas këtyre ngjarjeve dhe për shkak të marrëveshjes, Elez Isufi u tërhoq nga jeta politike aktive. Kjo u vu re në zgjedhjet e dhjetorit të vitit 1922, ku nuk fitoi asnjë kandidat i grupit Përparimtar, por, të gjithë mbështetës të qeverisë së Zogut. Të njëjtin qëndrim Elez Isufi mbajti edhe në zgjedhjet për Asamblenë Kushtetuese të mbajtura në dhjetor 1923 në prefekturën e Dibrës. Kështu në këtë prefekturë opozita nuk pati kandidatë me përjashtim të disa kandidatëve të pavarur. Për pasojë mungoi konkurrenca elektorale në mes kandidatëve ashtu sikurse në rrethet e tjera. Si rezultat, zgjedhjet përfunduan në favor të kandidatëve mbështetës të Zogut, gjithsej 12 vetë, pasues dhe mbështetës të kryeministrit.<sup>70</sup>

### **Ngjarjet e qershor-dhjetorit të 1924 dhe Elez Isufi**

Në pranverë të vitit 1924 situata në Shqipëri filloi sërish të trazohej. Marrëdhëniet mes opozitës dhe qeverisë ishin mjaft të acaruara për shkak të parregullsive në zgjedhjet kushtetuese, si dhe të ngushtimit të hapësirave dhe lirive për opozitën. Acarimi arriti kulmin në fund të prillit 1924 pas vrasjes së Avni Rustemit. Varrimi i tij u kthye në një start për zhvillimin e ngjarjes së qershorit të vitit 1924, e cila ishte kurorëzim i lëvizjes së dështuar të Marsit të vitit 1922, që solli në pushtet opozitën. Kjo ngjarje pati si bazë fillestare Vlorën dhe më pas vala e revoltës ndaj Ahmet Zogut, u përhap në Shqipërinë e Mesme dhe Veriore.

Elez Isufi nga të dhënat dukej i paangazhuar në fillimet e kësaj ngjarjeje. Megjithatë, ai ishte nën vëmendjen e qeverisë dhe përfaqësuesit

<sup>68</sup> *AQSH*, F. 152, V. 1923, D. 19, fl. 1, Telegram i Ministrisë së Punëve të Brendshme dërguar prefekturës së Dibrës, Tiranë, 13 shkurt 1923.

<sup>69</sup> *Po aty*, F. 152, V. 1923, D. 19, fl. 1, dok. nr. 249, Telegram i prefektit të Dibrës, z. Neki Starova drejtuar Ministrisë së Punëve të Brendshme, Peshkopi, 13 shkurt 1923.

<sup>70</sup> Hilmi Verteniku, “Problemet për Asamblenë kushtetuese dhe zgjedhjet e vitit 1923”, në *Studime historike*, nr. 3-4, Tiranë: 1968, f. 135.

britanik H. Eyres. Eyres në kundërshtim me atë që kishte kërkuar në Lëvizjen e Marsit, tani e këshillonte E. Isufin të mos qëndronte asnjëherë por të angazhohej në ngjarjet politike dhe të merrte anën e Zogut. Në atë kohë në Sllovë ndodhej zonjusha angleze Sibil Llojd, që shërbeu si ndërlidhëse mes E. Isufit dhe H. Eyres. Ajo i përcolli konsideratat e legatës: “si burrë i ndershëm dhe me dinjitet, besnik dhe si patriot... na ke dhënë fjalën se do të qëndrosh i paanshëm...porse tashti situata politike ka ndryshuar dhe duhet të bashkëpunosh me Zogun për të mirën e vendit”.<sup>71</sup> Elezi ishte përgjigjur se: “I thoni legatës se unë nuk kam punë ma me politikën që tash ka nevojë Zogu. Do të rri i paanshëm në shtëpi dhe do ta mbaj fjalën që kam dhënë në Tiranë”.<sup>72</sup> Ky interesim i legatës britanike ishte në të njëjtën linjë si në marsin e 1922, ajo ishte e interesuar që në pushtet të ishte Zogu, për të ruajtur stabilitetin politik në Shqipëri e rajon, si dhe pa nënvleftësuar mbrojtjen e interesave koncensionare të kompanive britanike në Shqipëri.

Por, studiuësja e Universitetit të Prishtinës, prof. Emine Bakalli është e mendimit se Elez Isufi nuk qëndroi krejtësisht i paanshëm ndaj ngjarjeve të qershorit.<sup>73</sup> Megjithëse nuk u angazhua me armë në revolucionin e qershorit, nga fillimi i muajit qershor 1924, me qëllim për të shmangur konfliktin midis parisë në Dibër, që ishte pro dhe kundra Zogut, bëri përpjekje për të bindur një sërë krerësh pari të Dibrës për të mbajtur një qëndrim neutral. Për këtë organizoi një mbledhje me disa nga krerët e Dibrës te varret e Deli Hasanit, ku lidhën besën se nuk do të lejonin që të përdroreshin armët brenda qytetit. Me këtë lëvizje Elez Isufi kërkonte të arrinte, nga njëra anë shmangien e një konflikti civil në Dibër, dhe nga ana tjetër kërkonte të dobësonte influencën e Zogut në Dibër të Poshtme dhe siguronte në radhët e parisë një bazë mbështetëse për qeverinë e Nolit. Ky takim i Elezit pati efekte, pasi një pjesë e parisë u tërhoq, ndër këta edhe Dine Hoxha e Murat Kaloshi (dhëndurët e Elezit-pari në Dibër) dhe disa të tjerë, që njiheshin si mbështetës të Zogut. Përpjekja për një qëndrim “neutral” ishte në disfavor të qeverisë së Zogut, e cila gjithnjë e më shumë po humbiste terren përballë opozitës së rebeluar.

<sup>71</sup> *Revolucioni i Qershorit 1924 në kujtimet e bashkëkohësve ...*, f. 180.

<sup>72</sup> *Po aty*, f. 181.

<sup>73</sup> Emine Bakalli, “Qeveria demokratike e Nolit dhe qëndrimi i mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene (SKS) ndaj saj”, në *Gjurmime Albanologjike*, seria e shkencave, nr. 11, Prishtinë: 1981, f. 257.

Gjatë periudhës qershor-dhjetor 1924 veprimtaria e E. Isufit konsistoi në përpjekjet për krijimin e besimit reciprok mes popullit dhe qeverisë. Qëndrimin e tij karshi qeverisë së Nolit, E. Isufi e përshkruante në letrën dërguar Bajram Currit. Sipas letrës populli e kishte mirëpritur reformën e çarmatimit që kishte ndërmarrë qeveria dhe do të mbështeste programin e saj.<sup>74</sup> Ai sugjeronte se kjo qeveri duhet të punojë fort me energji dhe kurajë për të fituar mbështetjen e popullit: “jemi gati me mos kursye asnjë shërbim për t’u zbatue deri në fund programi i qeverisë së sotme me sukses e faqe të bardhë”.<sup>75</sup> Në letrën e tij ndër të tjera kërkonte që Reçi, Dardha krahina e Trojakut e Kalasë së Dodës, të mos i nënshtroheshin çarmatimit...<sup>76</sup> për shkak se armët i duheshin popullit të krahinave kufitare për t’i bërë ballë çdo sulmi. Kjo ishte një kërkesë e tepruar, në një kohë kur qeveria e Nolit kishte deklaruar se nuk do të bënte përjashtime dhe çarmatimi do të përfshinte të gjithë, mbështetës ose jo të kësaj qeverie. Por edhe qeveria e Nolit si dhe paraardhësja e saj që kishte bërë diferencime, nuk shpëtoi nga sindroma për t’i patur disa krerë si mbështetje.

Në mbështetje të qeverisë së re, E. Isufi organizoi në xhaminë e Peshkopisë më 15 shtator 1924 një kuvend me pjesëmarrjen e krerëve të Dibrës që mbështetnin qeverinë. Kuvendin, ose siç njihet ndryshe “Kongresi i Malësisë së Dibrës”, e hapi Elez Isufi, ku bënte thirrje për mbështetjen e qeverisë, për bashkim e besë, dhe siç shprehej më tej Elezi: “bashkimi ia lehtëson punën qeverisë për zbatimin e ligjit”.<sup>77</sup> Aty u dënuan vrasjet, grabitjet, shpifjet, kalimi pa leje i kufirit etj., këtë besë atdhetari dibran u mundua ta shtrinte dhe në krahina të tjera deri në Lumë.

<sup>74</sup> *AQSh*, F. 818, V. 1924, D. 8, fl. 163, Letër e Elez Isufit, dërguar Bajram Currit, Peshkopi, 10 korrik 1924.

<sup>75</sup> *Po aty*. “Populli i Dibrës ka një bashkim të plotë sod sa që nuk e ka pasë kurrë me gjithë këtë, prapë shtrëngohem me ju shënue këtu se disa malsina duhet të mbahen e të mos lëshohen dores sidomos Reçi, Dardha e krahina e Trojakut dhe krahina e Kalasë së Dodës, të cilat i njifni fort mirë edhe Zotnia e juaj se janë besnikët e atdheut e nuk e kanë tradhtue kurrë, dhe prandaj këtyne e shof të arsyeshme që t’u nepet leje për të mbajtë armë me qenë se konsiderohen si ushtar gati e gjithmonë. Këto armë, nuk tham që ti bajnë në krah por t’u ndodhen në shtëpia”.

<sup>76</sup> *Po aty*.

<sup>77</sup> *AQSH*, F. 152, V. 1924, D. 82, fl. 5, Mbledhje e zhvilluar në xhaminë e Peshkopisë, 15 shtator 1924.

Një hap të tillë ai e vlerësonte si faktorin vendimtar në mbrojtje të punës së qeverisë.<sup>78</sup> Ai u angazhua me forcat e tij të vendoste rendin dhe qetësinë, në krahinat që ai kishte influencë.<sup>79</sup>

Ndërkohë që E. Isufi jepte kontributin e tij për forcimin e qeverisë së Nolit, Zogu së bashku me mbështetësit e tij kishte nisur përpjekjet për rikthimin në Tiranë. Përgatitjet kishin përfshirë Dibrën e Madhe, Strugën dhe Prizrenin ku ishin vendosur të arratisurit. Nënprefektura e Lumës njoftonte se Zogu kishte vajtur në Prizren ku mbështetësit e tij kishin regjistruar rreth një mijë komita. Po ashtu në katundin Vranisht të Jugosllavisë kishin sjellë armë e municione.<sup>80</sup> Në zonën kufitare të Dibrës hynin e dilnin çeta të drejtuara nga Abdurrahman Krosi, Shaqir Dema e Hysni Dema, të cilët shpërndanin të holla për të rekrutuar forca mercenare kundër qeverisë së Tiranës.<sup>81</sup> Përveç se në Jugosllavi, Zogu angazhoi mbështetësit e tij edhe në Greqi, Itali dhe atyre brenda vendit për t'u rikthyer në pushtet.

Qeveria e Nolit nuk po reagoje sa duhej edhe pse kishte rënë në dijeni të përgatitjeve të tyre. Ajo po tregohej mjaft e ngathët në drejtim të marrjes së masave ushtarake, për të mbrojtur kufirin, sidomos në sektorin e Dibrës. Qëndrimi indiferent i qeverisë së Nolit sillte demotivim në radhët e parisë, e cila dita-ditës po kuptonte se rikthimi i Zogut ishte i pashmangshëm dhe jo i largët. Në këtë situatë ajo filloi të lëkundej dhe ta kthente gunën andej nga po frynte era. Për më tepër një pjesë e parisë nuk e kishte fshehur mbështetjen dhe simpatinë për Zogun dhe ndër këta ishin dhe edhe dy miqtë e Elezit, Dine Hoxha dhe Murat Kaloshi. Luhatjet e parisë i pohon edhe prefekti i Dibrës në telegramin dërguar MPB, ku theksonte: "Parija pos Elez Isufit të gjithë na tradhtuen. Elezi me Reç e Dardhë ndodhet në Peshkopi. T'arratisurit sot do të mësyjnë prej tri

<sup>78</sup> *Revolucioni i Qershorit 1924 në kujtimet e bashkëkohësve ...*, f. 21.

<sup>79</sup> *AQSH*, F. 228, V. 1924, D. 28, fl. 1, Letër e parisë së Dibrës Hysni Dema, Fiqiri Dine, Taf Kaziu, dërguar Ahmet Zogut, Dibër, 29 korrik 1924.

<sup>80</sup> *Po aty*, F.152, V. 1924, D. 97/1, f. 197, Telegram nr. 195 Res, i zv/nënprefektit të Krumës dërguar zyrës sekrete të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Krumë, 2 tetor 1924.

<sup>81</sup> *Po aty*, f. 192, Telegram i zv/ komandantit të qarkut Dibër dërguar Komandës së Përgjithshme të Xhandarmërisë, Peshkopi, 2 tetor 1924.

anësh: Gollobordës, Maqellarës dhe Skërtecit. Gjendja e këtij qarku është e rrezikshme”.<sup>82</sup>

Në këtë situatë, Elez Isufi ishte i shqetësuar, çka duket në komunikimet e vazhdueshme që kishte me qeverinë nëpërmjet Bajram Currit, ku informonte rreth gjendjes në Dibër. Ai ngrinte një sërë problemesh dhe mangësish që shfaqeshin si, mungesa e forcave të mjaftueshme për mbrojtjen e kufirit, aktiviteti i lirshëm që kryenin agjentët e Zogut brenda territorit shqiptar, futja e parasë brenda dhe blerja e parisë, dhe si rezultat paria po ndryshonte qëndrim, dhe po shfaqte shenja për mbështetje ndaj Zogut. Në korrespondencën që E. Isufi kishte me Bajram Currit në një moment shprehej i revoltuar: “ Ju paralajmëroj se Zogu i ka ndezur zjarret...po përgatitet të futet në Shqipëri... Ta dini se përveç meje të gjithë bejlerët dhe agallarët e Dibrës japin shenja se do ta përkrahin hyrjen e Zogut në Shqipëri...”<sup>83</sup> E. Isufi njoftoi edhe ministrin e Luftës Rexhep Shalën dhe deputetin Kristo Dako, të cilëve u bënte të njëjtën kërkesë për marrje masash. Njëra nga letrat ishte lexuar edhe nga Noli, i cili më pas shprehej: “E di, plaku nuk shkruan gënjeshtër dhe nuk gabohet”.<sup>84</sup>

Qeveria e Nolit pavarësisht informacioneve dhe kërkesave që vinin nga Dibra dhe zonat kufitare të saj, të cilat e ndjenin më shumë këtë rrezik, që po afronte, nuk kishte marrë masat e duhura dhe nuk po realizonte një nga pikat më thelbësore të programit të saj, çështja e qetësisë dhe e sigurisë, po humbiste çdo ditë dhe po krijonte pakënaqësi në bazë. Përveç pakënaqësive të brendshme qeveria po përballlej edhe me trysninë e vazhdueshme të mungesës së legjitimitetit të saj. Takimet e kryeministrit gjatë kohës që ishte jashtë prej një muaj e gjysmë i dhanë të kuptonte se duhej të zhvillonte zgjedhjet parlamentare. Qeveria e Nolit e paaftë për të kryer detyrat që kishte përcaktuar në programin e saj, kundër vullnetit të saj, pranoi zhvillimin e zgjedhjeve politike. Dekreti u firmos nga S. Peçi më 13 nëntor 1924 dhe zgjedhjet do të zhvilloheshin pas një muaji.<sup>85</sup>

Pas 13 nëntorit, me shpalljen e zgjedhjeve politike në Shqipëri, Zogu me mbështetësit e tij intensifikuan përpjekjet për të shkurtuar ditët e

<sup>82</sup> *AQSH*, F.152, V. 1924, D. 98, fl. 142, Telegram i zv/prefektit të Dibrës, M. Qamil, dërguar zyrës sekrete të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Peshkopi, 16 dhjetor 1924.

<sup>83</sup> *Revolucioni i Qershorit në kujtimet ...*, f. 183-184.

<sup>84</sup> I. Strazimiri, *Lufta kundër pavarësimin ...*, f. 96.

<sup>85</sup> *Historia e Popullit Shqiptar ...*, vëll. III, f. 239.

qeverisë së Nolit. Lëvizjet e tij Beograd-Dibër e Madhe dhe anasjelltas, ishin të shpeshta<sup>86</sup>.

Sulmi fillimisht nisi në prefekturën e Kosovës më 14 dhjetor 1924 dhe pas rënies së Kukësit, më 16 të këtij muaji nisi në Dibër dhe brenda 24 orësh ra dhe Peshkopia në duart e forcave pro Zogut<sup>87</sup>. Për sa i përket qëndrimit të parisë së Dibrës rezultonte se ajo ishte bashkuar me Zogun dhe më datë 17 dhjetor kishte rënë Peshkopia,<sup>88</sup> përjashtim bëri vetëm Elez Isufi dhe Isuf Xhelili me mbështetësit e tyre nga Reçi e Dardha. Gjatë përpjekjeve që u bënë mes forcave pro Zogut dhe atyre qeveritare, ku këto të fundit u mbështetën nga Elez Isufi dhe i nipi Isuf Xhelili me mbështetësit e tyre, rezultoi që forcat e drejtuara nga Zogu të arrijnë sukses, dhe në këtë përplasje Elez Isufi u plagos rëndë ndërsa Sufë Xhelili, mbeti i vrarë<sup>89</sup>. Prej plagëve të marra, pak ditë më vonë pikërisht më 30 dhjetor 1924, Elez Isufi ndërron jetë në kullën e tij në Sllovë.<sup>90</sup>

Në kujtimet e tij për këtë ngjarje Ismail Strazimiri shkruante: Nëse Elez Isufi do të kishte marrë në dorë organizimin e rezistencës, dhe nuk do shpërndante përgjegjësinë sa tek prefekti, e komandantët dhe do të hidhej në ballë, ashtu siç kishte bërë edhe më parë, po të kishte ardhë në kohë në Lumë Bajram Curri, po të mos kishte tradhtuar Qamil Gelqerja (prefekti i Dibrës) apo dhe komandantët Ali Rizaj, Hamza Kuqi e Mujo Peja, në asnjë mënyrë Ahmet Zogu nuk do mundesh të futej nga Dibra”.<sup>91</sup> Nga e gjithë kjo mendoja se Elezi i vetëm me një fuqi prej 200 forcash nuk do iu bënte ballë të ndalte forcat pro Zogut që vinin nga jashtë dhe ato të brendshme që sa vinin e shtoheshin, por që të ishte e suksesshme rezistenca duhej të funksionin të gjitha hallkat.

<sup>86</sup> *AQSH*, F. 149, V. 1924, D. I/566, fl. 60, Telegram i prefektit të Dibrës, dërguar Ministrisë së Luftës, Peshkopi, 15 nëntor 1924.

<sup>87</sup> *Po aty*, F.152, V. 1924, D. 98, fl. 311, Telegram i zv/nënprefektit R. Drini dërguar zyrës sekrete të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ugrej-Bicaj, 20 dhjetor 1924.

<sup>88</sup> *Po aty*, fl. 208, Telegram i zv/nënprefektit të Matit, Sali Ohri, dërguar zyrës sekrete të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Kurdari, 17 dhjetor 1924.

<sup>89</sup> *Po aty*, fl. 311, Telegram i zv/nënprefektit, R. Drini, dërguar zyrës sekrete të Ministrisë së Punëve të Brendshme, Ugrej-Bicaj, 20 dhjetor 1924.

<sup>90</sup> Nevila Nika, “Kontributi i Elez Isufit në Revolucionin e Qershorit”, në *Elez Isufi, trajtesa dhe dokumente*, Tiranë: Marin Barleti, 1996, f. 101.

<sup>91</sup> I. Strazimiri, *Lufta kundër pavarësimi...*, f. 165.

Si përfundim, Elez Isufi mbetet një nga prijësit popullorë më në zë të trevës së Dibrës, i cili e udhëhoqi popullin e kësaj treve në bashkëpunim me krerë të tjerë lokalë në periudhën më të vështirë historike përgjatë viteve 1912-1921 kundër forcave serbo-jugosllave ku fati i saj u vu seriozisht në rrezik nga copëtimi i mëtejshëm i kësaj treve. Veprën e tij populli i kësaj treve e ka gdhendur në vargje: *Hajde-hajde Elez Aga/ke nantë vjet lufton me krajla*.

Përprjekjet e tij në shërbim të çështjes kombëtare do të vazhdojnë edhe gjatë viteve 1921-1924 por, ndryshe më parë, në ndonjë ngjarje ku ai kishte qenë ndër protagonistët kryesorë, në gjendje dobësie apo edhe i manipuluar nga pushtetarë që kishin humbur privilegjet, vuri në rrezik seriozisht qeverinë dhe stabilitetin e vendit gjë për të cilën edhe vetë është shprehur i penduar se ishte gabuar.

Gjatë periudhës së viteve 1921-1924, E. Isufi mbajti qëndrim opozitar jashtë parlamentit, nuk bashkëpunoi me Zogun për gjatë kësaj periudhe edhe pse ky i fundit duke e vlerësuar, i kishte bërë thirrje disa herë për bashkëpunim. Tek E. Isufi ushtruan ndikim të madh irredentistët kosovarë, duke qenë në fillim anëtar i Komitetit “MKK” dhe duke ndarë me ta të njëjtin shqetësim për fatin e Kosovës dhe Dibrës së shkëputur nga trugu i Shqipërisë. Pavarësisht dëshirës së mirë të tyre për të realizuar këtë ëndërr që në fakt për kohën ishte e pamundur solli këtë përplasje me Zogun për shkak të qëndrimit të tij kundërshtues, por që ishte në unison me qëndrimin e Tiranës zyrtare në lidhje me idetë irredentiste. Ky ndikim te Elezi mbeti i fortë deri në fund të jetës së tij, dhe ishte një nga arsyet kryesore të mosbashkëpunimit me Zogun pikërisht në momentet më të rëndësishme për vendin, të ngritjes dhe konsolidimit të shtetit shqiptar, kur vendi kishte nevojë për të gjithë patriotët që pa dallim të ishin të bashkuar për të mirën e vendit.

### *S u m m a r y*

#### THE ACTIVITY OF ELEZ ISUFI DURING THE PERIOD 1920-1924

Elez Isufi remains one of the most famous fighters of Dibra region who led the province with other fighters the national war against Serbian forces during

---

the period 1912-1921. After the release of Diber, he again engages in the establishment and consolidation of the state institutions.

His efforts to resolve national issues continued during the years 1921-1924 but, unlike the war with the Serbs, in one event (movement of March 1922), where he had been the main protagonists in weakness or manipulated by rulers who had lost their privileges, seriously risked the stability of the government and the country for which he admitted that he was regretful. For this event which had a leading role, Elez Isufi we have been critical, because such action was against the efforts to democratize the country and to consolidate the state. Special attention was paid to his relations with Ahmet Zogu where lack of cooperation was displayed. This lack of collaboration originates from the first parliamentary elections of Diber in 1921 and continued until December 1924 when Elez Isufi was killed by Zogu I.

In this article I have tried to give answers to some questions that are raised: What was the role of Elez Isufi in the first parliamentary elections in 1921 in the prefecture of Dibra? How many problems that appeared affected later the elections in the crisis events of December 1921 and the movement of March 1922? What factors encouraged Elez Isufi in this event? The Impact of the Kosovar at Elez Isufi. What was the relationship between E. Isufi and A. Zogu and later with F.S.Nolin til the end of his life?

